

I HYRJE

Qendra për Arsim e Kosovës (Kosova Education Center – KEC) është organizatë joqeveritare e themeluar nga Fondacioni "SOROS".

KEC ushtron veprimtari në fushën e edukimit dhe është e specializuar për trajnimin e punëtorëve të arsimit për zbatim të suksesshëm të strategjive bashkëkohore të mësimdhënies. Në kuadër të saj implementohen një numër i konsiderueshëm i projekteve ndër to edhe projekti: Të nxënët ndërveprues.

Projekti: "Të nxënët ndërveprues" financohet nga UNICEF dhe implementohet nga KEC në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Leximit (ARA).¹ Ai sendërtohet në 10 shkolla pilot të përzgjedhura nga UNICEF:



Nr.	Shkolla fillore	Vendi
1.	Elena Gjika	Prishtinë
2.	Shkolla fillore	Janjevë
3.	Rexhep Elmazi	Gjilan
4.	Emin Duraku	Kaçanik
5.	Shaban Jashari	Skënderaj
6.	Vaso P. Shkodrani	Pejë
7.	Hysni Dobruna	Junik-Deçan
8.	Meto Bajraktari	Mitrovicë
9.	Nezim Berati	Dragash
10.	Mihail Grameno	Rahovec

¹ ARA është organizatë joqeveritare profesionale me seli në Tiranë. Është implementuese e programit ndërkombëtar: "Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit." Është, gjithashtu, anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Leximit (IRA) me seli në Uashington.

HARTA E DHJETË SHKOLLAVE PILOT NË KOSOVË (TË NXËNËT NDËRVEPRUES)



Punoi: Florim ISUFI

II QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET E PROJEKTIT

A) QËLLIMI

Projekti ka për qëllim që të aftësojë arsimtarët për zbatim të metodave dhe strategjive të të nxënës në mënyrë që:

- të promovohet të menduarit krijues,
- të zhvillohen shkathtësitë dhe shprehitë për mësimdhënie efektive në klasë,
- të zhvillohen e formohen te nxënësit shkathtësitë e shprehitë për të nxënës ndërveprues,
- të përgatiten trajnerët potencialë

B) OBJEKTIVAT

B. 1. Objektiva e përgjithshme:

Objektivë e përgjithshme e projektit është që të trajnohen 200 punëtorë të arsimit nga 10 shkollat pilot dhe së paku 25 trajnerë potencialë.

B. 2. Objektivat specifike:

Për nxënës:

- të nxënë në bashkëpunim me të tjerët,
- të marrin përgjegjësi për të nxënë e tyre,
- të mendojnë në mënyrë kritike,
- të aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës

Për arsimtarë:

- të ndërtohen klasat që inkurajojnë të nxënë ndërveprues në mënyrë të hapur dhe të përgjegjshme,
- të përdorin strategjitë për mësimdhënie që promovojnë të menduarit kritik dhe të nxënë e pavarur,
- të përdorin repertuarin e teknikave efektive që promovojnë ndërveprim dhe pavarësi të të nxënës në harmoni me kurrikulumin.

Për trajnerë:

- të zhvillojnë aftësi komunikimi me të tjerët,
- të transmetojnë në mënyrë efektive njohuritë e fituara te kolegët tjerë,
- të demonstrojnë teknikat e reja të mësimdhënies së të nxënës ndërveprues në mënyrë të suksesshme.

C) AKTIVITETET

Janë paraparë 5 seminare trajnuese, katër dhe dy ditore me gjithsej 84 orë si dhe 2 seminare dy ditore për trajnerë me gjithsej 24 orë.

C. 1. Kalendari i trajnimeve të mësuesve:

Seminari	Datat e trajnimeve
I.	27-30 gusht 2001
II.	6-7 tetor 2001
III.	8-9 dhjetor 2001
IV.	3-6 janar 2002
V.	2-3 mars 2002

C. 2. Kalendari i trajnimeve të trajnerëve:

Seminari	Datat e trajnimeve
I.	30-31 mars 2002
II.	20-21 prill 2002

Seminaristët në varësi të rezultateve të treguara cerifikohen si: pjesëmarrës, mësues dhe trajnerë të të nxënit ndërveprues. Këta të fundit (trajnerë) pas një përvoje relevante në trajnimin e të tjerëve.

